

AKT- THEMELIMI

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"BLUE & BEAN Ventures"shpk**

Ne Durres, sot me date 07/03/2025, ortaket themelues te shoqerise
"BLUE & BEAN Ventures"shpk

Z. Fabio Fatelli, i datelindjes 27.10.1963 , lindur ne Bari e banues ne Itali , shtetas Italian, madhor, dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me numer identifikimi **YA8911473**

Z. Alberto Artes, i datelindjes 12.11.1965, lindur ne Trieste e banues ne Itali, shtetas Italian, madhor, dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me numer identifikimi **YB6115131**.

Z. Gianluca Ugolini i datelindjes 09.03.1964, lindur ne Modena e banues ne Itali, shtetas Italian, madhor, dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me numer identifikimi **YB1977405**.

Te cilet me cilesine e "Ortakeve themelues" kerkuan redaktimin e ketij akti themelimi, nepermjet te cilit deklaroi se me vullnet te lire te plote e te singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare", ligjin nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregetare, me pergjegjesi te kufizuar, "BLUE & BEAN Ventures"shpk.


KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria "BLUE & BEAN Ventures"shpk

Eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").



Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria **“BLUE & BEAN Ventures”shpk**, eshte nje shoqeri tregetare, e themeluar nga shtetasit Italian:

Z. Fabio Fatelli, Z. Alberto Artes, Z. Gianluca Ugolini te cilet pergjigjen per detyrimet e shoqerise tregetare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakeve perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne: Durrës, Lagjia 3, Rruga Pal Engjelli, Mbrapa bashkise, Objekt Nr. Pasurie 3/399/ND-N10, Kati i dyte, Zone Kadastrale 8514. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filial, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakeve themelues.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shoqeria ofron sherbim për zhvillimin e aktiviteteve të konsulencës

- a) Import/Eksport në Itali dhe Europë;
- b) Konsulencë
- c) pasuri të paluajtshme;
- d) Zhvillimi, tregtia, prodhimi dhe import/eksporti i sektorit agroushqimor;
- e) Ndërtimi;
- f) Inxhinieri Ndërtimi;
- g) Të tjera në marrëveshje.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.



KREU II

Kapitali

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 200,000 (dyqind mijë lekë), i cili ndahet ne 3 kuota, ne raport me kontributin e dhene nga ortaket ne shoqeri ku ortaket zoterojne kuota te ndare si me poshte :

Ortaku, **Z.Fabio Fatelli**, zoterues i kuotave me vlere te pergjithshme 98.000 leke, qe perbejne 49 % te kapitalit themeltare te shoqerise.

Ortaku **Z.Alberto Artes** zoterues i kuotave me vlere te pergjithshme 98.000 leke, qe perbejne 49 % te kapitalit themeltare te shoqerise.

Ortaku **Z. Gianluca Ugolini** zoterues i kuotave me vlere te pergjithshme 4000 leke, qe perbejne 2 % te kapitalit themeltare te shoqerise.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuota e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.


Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit".Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8



Organi Vendimmarres

Ortakët e shoqërisë janë organi vendimmarres i shoqërisë. Ortakët e shoqërisë janë organi vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Ortakët vendosin për çështje si :

- a) Përcaktimi i politikave tregëtare të shoqërisë
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar
- d) Përcaktimin e shpërblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) Përfaqesimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblese;

Të gjitha vendimet e marra nga ortakët e shoqërisë regjistrohen në një regjister të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për :

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e përegjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmerinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmerinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9 **Administrimi**



Administrator i shoqërise “BLUE & BEAN Ventures” shpk caktohet brenda ortakërise.

Z. Oronzo Antonio Longo emërohet Administrator i shoqërise për një afat 5 vjeçar me të drejtë riperteritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së ortakëve të shoqërise.

Neni 10 **Kompetencat**




Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- a) Kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërise, duke zbatuar politikën tregëtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Përfaqësojë shoqërinë tregëtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabel të shoqërise;
- d) Përgatit dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqesin këto dokumenta përpara asamblese së përgjithshme për miratim
- e) Krijoi një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcenojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërise
- f) Kryej regjistrimet dhe dergojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërise siç parashikohet në ligjin për QKR.
- g) Raportoi përpara asamblese së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërise tregëtare.

Administratori është i detyruar të thërrasë në mbledhjen e asamblese në rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme Brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërise, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratoret, si së bashku edhe veças njëri tjetrit, kanë të drejtë të kryen të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratoret e përfaqësojnë shqiperin përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe



/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shtetere shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratoret kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqeris, net e gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ja jep shprehimisht ortakeve te shoqeris.

Administratoret angazhon shoqerin ne mardheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj. Shoqeria nuk merR persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti I administratorit e kalonte objektin e shoqeris ose per te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk esht prov e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti Financiar i shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht , viti i par Financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet ne 31 dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b) me vendim te ortakve themelues
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk esht njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 , date 3.5.2007 "Per Qendren Kombtare te Biznesit"
- e) me vendim te gjykates

Ne kete rast Asambleja e Pergjithshme merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " shoqeri ne likuidim e siper"

Neni 13


Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjiit "Per tregtaret dhe shoqerit tregtare", Kodit Civil dhe cfar do ligji tjeter specific ne Republiken e Shqiperis.

Neni 14

Dispozita perfundimtare





Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare **"BLUE & BEAN Ventures" shpk** nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin , mbiemrin dhe firmen e tij origjinale .

ORTAKET THEMELUES

Fabio Fatelli
Alberto Artes
Gianluca Ugolini

FABIO FATELLI


ALBERTO ARTES


GIANLUCA UGOLINI
